



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	31.08	20	<i>Og</i>
Nj. Org.	Numër	Shtoja	Vlera
	610-5370		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës të dt.21.05.2008 në pajtim me procedurat ligjore, në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, përkatësisht të Nenit 79 rrëth detyrave dhe përgjegjësive të Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtori i DKA-së nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e aktiveve profesionale-lëndore dhe klasore në nivelin komunal për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.

-Me këtë Vendim, DKA formon aktivet profesionale lëndore në nivelin komunal për të gjitha shkollat e mesme të ulëta, ndërsa për arsimin fillor aktivet komunale formohen në nivel klase nga e para deri të pestën.

-Secili aktiv i lëndës përkatëse dhe aktivet klasore përkatëse do të mbajnë mbledhje të rregullt një herë në muaj në nivelin komunal dhe secili mësimdhënës është i obliguar të marrë pjesë në mbledhje dhe kërkohet nga ai përgjegjësi dhe kontribut maksimal për zbatimin e planprogrameve mësimore mujore dhe vjetore të koordinuara në nivelin e aktivit komunal.

A R S Y E T I M

Vendimi i DKA-së për formimin e aktiveve profesionale lëndore dhe klasore në nivelin komunal nga të gjitha shkollat filllore dhe të mesme të ulëta është rasti i parë dhe deri më tani i vetëm në nivel Shteti, që vjen si domosdoshmëri e rrethanave të reja për zhvillimin dhe funksionimin e sistemit arsimor të reformuar në Republikën e Kosovës, për zbatimin e metodologjive të reja bashkëkohore për nxënësin në qendër të vëmendjes. Formimi dhe funksionimi i tyre në nivelin komunal, do të ndikoi në masë të madhe përritjen e cilësisë në arsim, si njëra ndër objektivat kryesore të MASHT-it.

Të gjithë mësimdhënësit që janë pjesë e aktiveve përkatëse kanë obligim të marrin pjesë në këto takime për arsy se në kontratat e mësimdhënës janë 40 orë pune në javë dhe për arsy të mungesës së mjeteve të konkretizimit dhe hapësirave në objektet arsimore nuk kërkohet qëndrimi i mësimdhënësve nga 8 (tetë) orë në ditë. Prandaj DKA obligon të gjithë mësimdhënësit të jenë aktiv në aktivet profesionale të lëndëve përkatëse si kontribues të drejtëpërdrejtë të ngritjes së cilësisë në arsim në Komunën tonë.

Takimet e përbashkëta të mësimdhënësve të lëndëve përkatëse në aktivet komunale e mundësojnë dhe e lehtësojnë komunikimin ndërkolegjal të mësimdhënësve, ku përmes debateve të hapura do të nxjerren konkluzione të përbashkëta të cilat do të analizohen nga DKA dhe do të përcillen në MASHT me qëllim të ndikimit pozitiv në hartimin e planprogrameve mësimore.

VËREJTJE: Pjesëmarrja e mësimdhënësve në aktive komunale evidentohet në çdo takim dhe do të vlerësohet puna e secilit. Ndërsa mungesa në mbledhje të takimeve konsiderohet shkelje e kontratës së punës si mungesë në orarin e punës dhe do të mirren masa administrative dhe financiare.

Ky vendim hynë në fuqi që nga data 01.09.2009.

Drenas, më 31.08.2009

Drejtori i DKA-së:

[Signature]
Arsim Mehmeti, prof.

